



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:049921
Datë: 21.07.2023
Numri i dokumentit: 04508961

C.nr. 101/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Nehat Qelaj, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S. M. nga fshati G., Komuna e Klinës, të cilin e përfaqëson avokat Agron Kryeziu nga Malisheva, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, të cilën e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj nga Malisheva, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë (shujtës), vlera objektit të kontestit 660.00 Euro, jashtë seancës, me datë 21.07.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit S. M. nga fshati G., Komuna e Klinës, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, që paditësit t’ia paguaj kompensimin në emër të shpenzimeve të ushqimit (shujtës) shumë të përgjithshme prej 660.00 Euro, duke llogaritur nga 2.00 Euro për 330 ditë të vajtjes në punë, për periudhën prej datës 01.02.2020 e deri me datë 21.11.2022, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë data 12.03.2021, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësit t’ia paguaj shumë prej 229.00 Euro, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit S. M. nga fshati G., Komuna e Klinës, në këtë gjykatë përmes të autorizuarit e tij ka ushtruar padi më datë 12.03.2021, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë (shujtës) në shumë prej 660.00 Euro.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse.

Paditësi më tej kanë theksuar se është i punësuar tek e paditura në Shkollën e Mesme Profesionale (SH.M.P) “L. P.”, në fshatin K., Komuna e Malishevës, në vendin e punës mësimdhënës dhe atë me kontratë pune. Duke shtuar se e paditura në bazë të Kontratës Kolektive përkatësisht nenit 35 par. 7 ka qenë e obliguar që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e ushqimit (shujtës) në punë. Përmes parashtresës së datës 17.01.2023, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka bërë precizimin e padisë duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi dhe ta detyrojë të paditurën në pagesën e shpenzimeve të ushqimit (shujtës) në punë si në vijim: Paditësit S.M., shumën e përgjithshme prej 660.00 Euro, ku në emër të ushqimit (shujtës) në punë llogariten nga 2.00 (dy) Euro për 330 ditë të vajtjes në punë, për periudhën prej datës 01.02.2020 e deri me datë 21.11.2022, me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar, në vlerë të përgjithshme prej 229.00 Euro, dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 Euro, për parashtesën për precizimin e padisë 104.00 Euro, si dhe për pagesën e taksës gjyqësore shumën prej 21.00 Euro.

E paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, në përgjigjen në padi të datës 17.05.2021, ka theksuar se paditësi lidhur me pagesën e shujtës e ka realizuar në procedurën përmbartimore përmes vendimit të inspektoriatit të punës nr. ..., i datës 09.03.2020, si dhe urdhërit përmbartimore P.nr. 3266/2020, i nxjerr nga përmbartuesi privat A. M.nga Vushtrria, duke i propozuar gjykatës që çështjen ta konsideroj të përfunduar. Ndërsa lidhur me precizimin e padisë ka paraqitur përgjigje më datë 27.01.2023, përmes së cilës ka theksuar se e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi që kontrata kolektive nuk është në fuqi nga data 21.11.2022, dhe se e paditura nuk ka legjitimitet të palës aktive, sepse nuk është nënshkruar e kontratës kolektive të arsimit, duke i propozuar gjykatës që ta refuzojë padinë si të pabazuar ose kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës - MASHTI.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës nuk është deklaruar.

Gjendja faktike e vërtetuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Kontratën e punës për mësimdhënës, me numër të protokollit ..., e datës 07.09.2016; Vërtetimin për ditët e prezencës në punë me numër të protokollit ..., i lëshuar me datë 23.11.2022, nga SH.M.P “L. P.” në K., Komuna e Malishevës; Vërtetimin me numër të protokollit ..., i lëshuar me datë 03.03.2021, nga SH.M.P “L. P.” në K., Komuna e Malishevës; Vendimin e inspektoriatit të punës me nr. proto: ..., i datës 08.05.2020, Kërkesa për pagesën e shujtave si dhe udhëtimit, me nr. proto: ..., e datës 10.03.2021, e pranuar nga Komuna e Malishevës; si dhe kopjen e letërnjoftimit të S. M.të lëshuar nga MPB/ Republika e Kosovës.

Gjykata konstaton se për palët ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësi ka pasur të themeluar marrëdhënien e punës me të paditurën në nga SH.M.P. “L. P.” në K., Komuna e Malishevës, kjo është vërtetuar në bazë të kontratës së punës për mësimdhënës.

Me shikimin në vërtetimin për ditët e prezencës në punë me numër të protokollit ..., i lëshuar me datë 23.11.2022, nga SH.M.P “L. P.” në K., Komuna e Malishevës, vërtetimin me

numër të protokollit ..., i lëshuar me datë 03.03.2021, nga SH.M.P “L. P.” në K., Komuna e Malishevës, vendimin e inspektoriatit të punës me nr. proto: ..., i datës 08.05.2020, kërkesa për pagesën e shujtave si dhe udhëtimit, me nr. proto: ..., e datës 10.03.2021, e pranuar nga Komuna e Malishevës, si dhe kopjen e letërnjoftimit për S. M. të lëshuar nga MPB/ Republika e Kosovës, gjykata vërtetoi faktin se për periudhën prej datës 01.02.2020 e deri me datë 21.11.2022, paditësi S. M. ka 330 ditë pune, e për të cilat nuk është kompensuar asnjëherë deri më tani nga e paditura.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës.

Gjykata konform nenit 258 të LPK-së, ka aprovuar propozimin e palës paditëse, ashtu që ka lejuar ndryshimin e lartësisë së kërkesëpadisë në vlerën e përgjithshme prej 660.00 Euro, si në parashtresën për precizimin të datës 17.01.2023, me arsyetimin se ndryshimi është bërë para se të mbahej seanca përgatitore.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, parashtresën për plotësimin dhe zgjerimin e padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi si dhe në precizimin të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim kryesor të çështjes ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar sa i përket kërkesës për shpenzimet e ushqimit (shujtës) në punë.

Ligji nr. 03/L-212 i Punës, në nenin 90 par. 5 e përcakton se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”. Ndërsa sipas dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017, por edhe të datës 22.01.2021, në mënyrë të njëjtë kanë paraparë në nenin 35 par. 7 se: “*Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore*”. Sipas vlerësimit të gjykatës, këto dispozita gjykata janë bazë e mjaftueshme ligjore prej të cilave rrjedh e drejta e paditësit për kompensimin e kërkesës së tij për të cilin gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të lartcekura dhe faktit se Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-u, janë nënshkruese të Kontratës Kolektive të potencuar, gjykata vjen në përfundim se kjo kontratë kolektive prodhon efekt juridik për të gjithë të punësuarit në sektorin e arsimit që janë anëtarë të SBASHK-ut. Në këtë kuptim e paditura ka legjitimitet të plotë pasiv në procedurë.

Gjykata vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e ushqimit (shujtës) në punë për faktin se të gjitha këto janë të bazuara në provat të cilat janë elaboruar më lartë dhe duke i shumëzuar ditët e punës së vijueshmërisë së tyre sipas kërkesës me 2.00 euro për ushqim në ditë, dalin vlerat të cilat janë aprovuar për paditësin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e që bazohen në prova të qarta, të cilave gjykata iu fali besimin e plotë. Kështu, paditësit S. M., shumë e përgjithshme prej 660.00 Euro, ku në emër të ushqimit (shujtës) në punë llogariten nga 2.00 Euro, për 330 ditë të vajtjes në punë ($2 \times 330 = 660$), për periudhën prej datës 01.02.2020 e deri me datë 21.11.2022, me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë 12.03.2021.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë e përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Kështu që bazuar në dispozitat e këtij neni gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit ishte qartazi e themeltë, ka bazë në dispozitat e Ligjit nr.03/L-212 të Punës dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.01B-2056 e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.01B-105 e datës 22.01.2021, ndërsa shuma e kompensimit bazohet në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata analizoi edhe pretendimet e të paditurës, sipas të cilave pretendon se paditëses përmes procedurës përmbartimore i është përmbushur kërkesa për kompensimin e ushqimit (shujtave), sipas vendimit të Inspektoriati të Punës me nr. ..., i datës 09.03.2020, i cili është ekzekutuar përmes urdhërit përmbartimore P.nr. 3266/2020, të lëshuar nga përmbartuesi privat A. M. nga V., por që këto pretendime nuk qëndrojnë dhe nuk ka mbështetur me asnjë provë të vetme, ashtu që erdhi në përfundim se këto pretendime janë vetëm deklarative e të pambështetshme dhe se nuk kanë përmbushur kërkesat ligjore, të cilat do të kishin impakt që gjykata të vendos ndryshe nga ajo që ka vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket vendimit Inspektoriati të Punës me nr. ..., i datës 09.03.2020, gjykata nuk i’ a fali besimin kësaj prove dhe e konsideroj si irelevante për kontestin në fjalë, pasi që vendimi i inspektoriatit ka përfshirë periudhën e gjeri në datën e lëshimit të tij, ndërsa në petitumin e kërkesëpadisë paditësja ka kërkuar kompensimin për periudhën nga data 01.02.2020 e gjeri më datën 21.11.2022, që në këtë rast kërkesëpadia e paditëses është e periudhës pas vendimit të inspektoriati gjë që e njëjta nuk ka mundur që të kërkohet nga paditësja, po ashtu e paditura nuk ka ofruar si provë as urdhërin përmbartimor P.nr. 3266/2020, të përmbartuesit privat, të cilin gjykata do ta trajtonte konform dispozitave ligjore.

Sa i përket pretendimeve të palës paditëse se Kontrata Kolektive nuk është e vlefshme, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë nr. 01B-105 e datës 22.01.2021, në periudhën kontestuese ishte në fuqi sepse sipas nenit 48 të kësaj kontrate parashihet që: *“Kjo Kontratë Kolektive hynë në fuqi pas nënshkrimit të dy palëve kontraktuese”*, ndërsa pas datës 21.11.2022, ku është shkëputur kontrata kolektive e arsimit në mënyrë të njëanshme e të cilën edhe vetë e paditura e ofruar si provë ndërsa nga paditësi nuk ka kërkuar ndonjë kompensim përtej kësaj datë, siç është cekur më lartë.

Vendimin lidhur me kumatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë më datë 12.03.2021, bazuar edhe në Mendimin Juridik për Kumatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, me nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Prandaj, duke u bazuar në të lartcekurat si dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par. 5 e Ligjit të Punës, nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr. 01B-105 e datës 22.01.2021, nenit 382 të LMD-së, por edhe të nenit 398 lidhur me nenin 142 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që e paditura t'ia kompensojë paditësve shumën si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e që përfshijnë: për përpilim të padisë shumën prej 104.00 Euro, për parashtrësën për precizimin e padisë shumën prej 104.00 Euro, si dhe taksën gjyqësore në shumë prej 21.00 Euro, në shumën e përgjithshme prej 229.00 Euro, sipas TA (Tarifës së Avokatëve të Kosovës).

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr. 101/2021, me datë 21.07.2023.

Bashkëpunëtor Profesional
Samir Morina

Gj y q t a r i
Nehat Qelaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës, në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplar të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.